
	<p><b>Republika e Kosovës</b> 01-14/12 Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-104339/24 dt. 08.08.2024, të kërkesit/pronarit “ERVB” shpk., me seli në Prishtinë, ne rr. “Dëshmoret e Gollakut”, Lagja Marigona Hill, pn., me investitor ”Marigona Hill” shpk me seli në Prishtinë, ne rr. “Dëshmoret e Gollakut”, Lagja Marigona Hill, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me pronarë Valton Bilalli dhe Rasim Mrlaku që të gjithë nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat/shtëpi individuale të banimit, të ndërtuara në kuadër të Planit Rregullues të Hollësisëm për Tërësinë urbane “B”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Lindje” në Prishtinë, në rr. “Teodor Keko”, dhe “Pjetër Gjoka”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 01.10.2024, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkesit/pronarit “ERVB” shpk., me seli në Prishtinë, ne rr. “Dëshmoret e Gollakut”, Lagja Marigona Hill, pn., me investitor ”Marigona Hill” shpk me seli në Prishtinë, ne rr. “Dëshmoret e Gollakut”, Lagja Marigona Hill, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me pronarëve Valton Bilalli dhe Rasim Mrlaku që të gjithë nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-104339/24 dt. 08.08.2024, përdorimi i ndërtesave/shtëpive individuale të banimit, përkatësisht 18 (tetëmbëdhjet), ndërtesa të tipit “D2”, me etazhitet B+S+P+1, të ndërtuara sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore” 05 Nr. 351/02-229888/19 dt. 02.12.2019, të lëshuar nga kjo drejtori, në parcelat kadastrale nr. 1239-32, 1239-33, 1239-34, 1239-35, 1239-36, 1239-37, 1239-38, 1239-39, 1239-15, 1239-196, 1239-17, 1239-18, 1239-19, 1239-20, 1239-21, 1239-22, 1239-23, 1239-24, ZK Hajvali, në kuadër të Planit Rregullues të Hollësisëm për Tërësinë urbane “B”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Lindje” në Prishtinë.

**II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Teodor Keko” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, 16, 18, dhe 20, në Prishtinë, dhe në rrugën “Pjetër Gjoka” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, dhe 16, në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësisive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

## Ar sy e t i m

Kërkuesit/ pronaret "ERVVB" shpk., me seli në Prishtinë, ne rr. "Dëshmoret e Gollakut", Lagja Marigona Hill, pn., me investitor "Marigona Hill" shpk me seli në Prishtinë, ne rr. "Dëshmoret e Gollakut", Lagja Marigona Hill, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me pronarëve Valton Bilalli dhe Rasim Mrlaku që të gjithë nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-104339/24 dt. 08.08.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesat shtëpi individuale të banimit, përkatësisht 18 (tetëmbëdhjet), ndërtesa të tipit "D2", me etazhitet B+S+P+1, e ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishem për Tërësinë urbane "B", të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Lindje" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1239-32, 1239-33, 1239-34, 1239-35, 1239-36, 1239-37, 1239-38, 1239-39, 1239-15, 1239-196, 1239-17, 1239-18, 1239-19, 1239-20, 1239-21, 1239-22, 1239-23, 1239-24, ZK Hajvali, ndërtuar sipas "Vendimit të Lejes Ndërtimore" 05 Nr. 351/02-229888/19 dt. 02.12.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-205279/23 dt. 01.07.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Alban Fazliu/Granit Islami; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Florjeta Ameti; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Kreshnik Maloku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Lirim Jusufi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Arber Bajraktari; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Arban Shala; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Alban Grajçevci me nr. të licensës 75 dhe kompania e licensur gjeodete "Geoservice Engineering" shpk me nr. të licensës 74 dhe;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, dhe instalimet e makineris, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat/shtëpi individuale të banimit mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.




Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat/shtëpi individuale të banimit, mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat/shtëpi individuale të banimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-104339/24 DT. 01.10.2024**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  


Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi



